



# iSIGURT.al

PLATFORMA KOMBËTARE PËR SIGURINË NË INTERNET  
Linja Kombëtare për Internet në Sigurt për Fëmijët

Në bashkëpunim me:



## FTESË

**Bëhu pjesë e Fushatës Kombëtare: Së bashku për një internet më të sigurt e më të mirë për fëmijët! Të mbrojmë fëmijët dhe të rinjtë në hapësirën dixhitale!**

Dita e Internetit të Sigurt (SID) organizohet çdo vit në muajin shkurt për të promovuar përdorimin e sigurt dhe pozitiv të teknologjisë dixhitale, veçanërisht midis fëmijëve dhe të rinjve. Në Shqipëri, dita organizohet nga Platforma Kombëtare për Internet në Sigurt ([ëëë.iSIGURT.al](http://ëëë.iSIGURT.al)) dhe Linja Kombëtare për Internet të Sigurt për Fëmijët, dy shërbime të specializuara në nivel kombëtar të CRCA/ECPAT Shqipëri, në partneritet me ALO 116: Linja Kombëtare e Telefonit të Ndhmës për Fëmijët. Platforma iSIGURT.al është anëtare e INHOPE dhe Insafe, organizatorë të ditës në nivel Europian dhe global. Në të gjithë botën, miliona njerëz bëhen së bashku për të sjellë ndryshime pozitive në internet dhe për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet e sigurisë. Edhe ju mund të luani rolin tuaj në këtë drejtim!



## Dita e Internetit të Sigurt

2024 | Të Martën  
6 Shkurt

[www.saferinternetday.org](http://www.saferinternetday.org)

[www.iSIGURT.al](http://www.iSIGURT.al)



**iSIGURT.al** – Platforma Kombëtare për Internet të Sigurt në Shqipëri ka si mision kryesor të saj mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga çdo formë e dhunës online, si dhe raportimin e gjuhës së urrejtjes në internet, dhe **ALO 116-111 - Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë**, që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve kur ata ndodhen në situatë rreziku dhe të sigurojë një qasje të përshtatshme që të gjithë fëmijëve ti garantohen më shumë shërbime në kuadër të një sistemi mbrojtës efektiv dhe parandalues. Gjithashtu edhe të këshillojë fëmijët përmes telefonit dhe të referojë nevojat e tyre në institucionet përkatëse ka kënaqësinë që t'ju ftojë të bëheni pjesë e Ditës Ndërkombëtare për Internet të Sigurt, që këtë vit organizohet në datën 6 Shkurt. **iSIGURT.al**, një shërbim kombëtar i ofruar nga CRCA/ECPAT Shqipëri, punon që nga viti 2015 për internet të

sigurt në Shqipëri, me fokus kryesor raportimin e krimeve seksuale ndaj fëmijëve dhe krimeve me bazë gjuhën e urrejtjes.

**Dita e Internetit të Sigurt** synon të krijojë një internet më të sigurt dhe më të mirë, ku të gjithë jemi të fuqizuar të përdorim teknologjinë me përgjegjësi, respekt, kritikë dhe kreativitet. Fushata synon të arrijë tek fëmijët dhe të rinjtë, prindërit dhe kujdestarët, mësuesit, edukatorët dhe punonjësit socialë, industrinë e internetit dhe komunikimit, vendimmarrësit dhe politikanët etj., për të inkurajuar të gjithë që të luajnë rolin e tyre në krijimin e një mjedisi në internet sa më të mirë për këdo. Duke festuar fuqinë pozitive të internetit, slogani i Ditës për Internet të Sigurt "**Së bashku për një internet më të mirë**" inkurajon të gjithë që t'i bashkohen lëvizjes, të marrin pjesë dhe të shfrytëzojnë sa më shumë potencialin e internetit për të bashkuar njerëzit.

**Në Shqipëri**, ku dita për internet të sigurt organizohet që nga viti 2005, do të ketë një sërë aktivitete publike të rëndësishme të organizuara nga **iSIGURT.al** dhe partnerët tanë. Këtë Shkurt ne do të bëjmë publik **Raportin Kombëtar për Internetin e Sigurt në Shqipëri**, që është një publikim i përvitshëm që tregon për incidentet që raportojnë fëmijët gjatë navigimit të tyre në internet si edhe **Raportin 6 vjeçar të raportimit të incidenteve të dhunës online për gratë dhe vajzat**.

**Përgatitja e projekt-ligjit "Për mbrojtjen dhe sigurinë personale në hapësirën dixhitale"** - si një nismë ligjore e cila do të garantojë mbrojtjen vetëm të qytetarëve në hapësirën dixhitale. Kjo ndërlihet edhe me premtimin që katër ministritë kanë ndërmarrë me nënshkrimin e **Paktit Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna Seksuale në Internet** në 20 Nëntor 2023.

Ndërkohë që në bashkëpunim me autoritetet publike dhe industrinë e internetit ne do të nënshkruajmë krijimin e **Aleancës Kombëtare për Internet të Sigurt**, si një rrjet joformal i organizatave, ekspertëve dhe institucioneve që duan të avokojnë për sigurinë dhe mbrojtjen e qytetarëve në hapësirën dixhitale si dhe fuqizonte zërin tonë në një fushë të re, por kaq të rëndësishme, si një përgjigje e koordinuar përkundrejt nevojës për më shumë mbrojtje për fëmijët dhe të rinjtë. Ndërkohë që **Fushata Kombëtare "Së bashku për një internet më të mirë"** do të hapet në datë 6 Shkurt me angazhimin e mësuesve, shkollave, fëmijëve dhe adoleshentëve, prindërve, për të nxitur një diskutim të gjerë shoqëror dhe mbi të gjitha informimin e prindërve dhe fëmijëve për sigurinë online.

**Secili nga ne mund t'a bëjë internetin më të sigurtë. Nëse doni të organizoni aktivitete dhe të luani një rol pozitiv në punën tuaj, në komunitetin ku jetoni, në zyrën apo familjen tuaj, kudo, ka shumë mënyra për ta bërë këtë:**

- **Fëmijët dhe të rinjtë** mund të ndihmojnë për të krijuar një internet më të mirë duke qenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve në internet, duke mbrojtur reputacionin e tyre në internet (dhe të të tjerëve) dhe duke kërkuar mundësi pozitive për të krijuar, angazhuar dhe shpërndarë në internet.
- **Prindërit dhe kujdestarët** luajnë një rol vendimtar në fuqizimin dhe mbështetjen e fëmijëve për të përdorur teknologjinë me përgjegjësi, respekt, në mënyrë kritike dhe krijuese, qoftë duke siguruar një dialog të hapur me fëmijët e tyre, duke i edukuar ata që të përdorin teknologjinë në mënyrë të sigurt dhe pozitive, ose duke vepruar si shembull për tu ndjekur në ndërveprimin online.
- **Mësuesit, edukatorët, psikologët, punonjësit socialë, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve dhe koordinatorët e rinisë**, mund të ndihmojnë për të krijuar një internet më të mirë duke i pajisur fëmijët dhe të rinjtë me aftësitë e shkrim-leximit dixhital dhe duke zhvilluar aftësitë e tyre të menduarit kritik, gjë që do t'i lejojë ata të lundrojnë më mirë në botën online. Mësuesit mund t'i fuqizojnë fëmijët dhe të rinjtë që ata të kodojnë, të krijojnë përmbajtje pozitive online, të bëjnë zgjedhjet e duhura në internet dhe si të japin shembullin e tyre personal të sjelljes pozitive në internet.

- **Shoqëria civile dhe mediat** luajnë një rol tepër të rëndësishëm për informimin e fëmijëve dhe të rinjve, prindërve, publikut të gjerë dhe politikë-bërësve mbi risqet me të cilat fëmijët përballen apo nxitjes së sjelljeve pozitive në internet, kërkimit të llogarisë nga zyrtarët publikë apo angazhimit në zhvillimin e politikave dhe ligjeve më të mira. Ndërkohë ata mund të ndërgjegjësojnë fëmijët që përfitojnë nga programet e tyre, se ku mund të kërkojnë ndihmë në rast të incidenteve apo të kërkojnë nga industria e internetit dhe komunikimit që ata të mbrojnë në mënyrë pro-aktive fëmijët dhe të rinjtë.
- **Industria** mund të ndihmojë në krijimin e një interneti më të mirë duke krijuar dhe promovuar përmbajtje pozitive dhe shërbime të sigurta në internet, dhe duke fuqizuar përdoruesit për t'iu përgjigjur çdo çështjeje duke ofruar këshilla të qarta sigurie, një sërë mjetesh sigurie të lehta për t'u përdorur dhe akses të shpejtë në mbështetje nëse gjërat shkojnë keq. Po ashtu industria në Shqipëri mund të nënshkruajë Kodin Praktikës, që nxit ndër të tjera kujdesin, mbrojtjen dhe përgjigjen adekuate ndaj çdo rasti të dhunës ekstreme apo seksuale ndaj fëmijëve në internet.
- **Vendimmarrësit dhe politikanët** duhet të sigurojnë një kulturë në të cilën të gjitha sa më sipër mund të funksionojnë dhe të lulëzojnë – për shembull, duke siguruar që në kurrikula të krijohet mundësia që fëmijët dhe të rinjtë të mësojnë për sigurinë në internet, duke siguruar që prindërit dhe kujdestarët të kenë akses në informacionin e duhur dhe burimet e mbështetjes, dhe ajo industri inkurajohet të vetë-rregullojë përmbajtjen dhe shërbimet e saj. Ata gjithashtu duhet të marrin drejtimin në qeverisje dhe legjislacion, dhe në fund të ofrojnë sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve përmes strategjive efektive të mbrojtjes së fëmijëve për botën dixhitale.
- **Të gjithë** kemi përgjegjësi për të patur një qasje të re të sjelljes sonë online. Ne të gjithë mund të promovojmë aspektet pozitive duke qenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve dhe duke kërkuar mundësi konstruktive për të krijuar dhe lidhur. Ne të gjithë mund t'i përgjigjemi çështjeve negative duke raportuar përmbajtjet dhe sjelljet e papërshtatshme ose të paligjshme në internet.

## KU GJENDEN MATERIALET NDËRGJEGJËSUESE?

Të gjitha materialet ndërgjegjësuere janë hedhur në faqen e web dhe janë të disponueshme për tu ruajtur apo kopjuar – sipas nevojave tuaja në lidhjen: <https://www.isigurt.al/fushata-ndergjegjesuese> - Materialet bazë që do të gjeni janë:

- **Posteri e fushatës online (të përgjithshëm dhe për ditë specifike)**
- **Shpjegimet bazë mbi fushatën e komunikimit, ku të na bëni tag e ku na gjeni.**
- **Fleta Informative me shpjegime për iSIGURT.al dhe ku e si mund të bëhen ankesat e incidenteve online**
- **Si të organizojmë një orë ndërgjegjësuere me fëmijët – Material për mësuesit, psikologët etj.**

**Të bëhemi së bashku për një internet të sigurt dhe më të mirë!**  
**Na shkruani në adresën tonë: [isigurt@crca.al](mailto:isigurt@crca.al)**

Mësoni më shumë rreth Ditës së Internetit të Sigurt në [www.iSIGURT.al](http://www.iSIGURT.al) dhe [www.saferinternetday.org](http://www.saferinternetday.org), ose qëndroni të përditësuar përmes profileve të mediave sociale SID në Facebook, Twitter dhe LinkedIn.